

## VENDIM

Nr. 833, datë 18.9.2013

### PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË MINISTRISË SË ENER GjISË DHE INDUSTRI SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), sipas këtij vendimi.

II. Ministria e Energjisë dhe Industrisë harton dhe zbaton politika që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjetike e minerare në funksion të zhvillimit

të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, si dhe nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa

më miqësore për mjedisin.

III. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Sektorin e energjisë elektrike;
2. Sektorin e hidrokarbureve (naftë dhe gaz);
3. Sektorin e minierave dhe gjeologjisë;
4. Sektorin e industrisë joushqimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama